

**«Kështjella****dhe****helmi»**

- Skënimet për dramën

dhe spektaklin -

**Ahmet Pzsha**

**E**dukimi i fëmijëve dhe i pionierëve, i këtyre filizave të Partisë që do të jenë trashëguesit e vetive më të larta e më të bukura të popullit tonë, duhet bërë artistikisht edhe nëpërmjet skenave të teatrove dramatike, të cilat deri tani nuk kanë dhënë aq sa duhet për të vegjëlit. Kohët e fundit, salla e Teatrit Popullor u gjallërua nga duartrokitjet dhe thirrjet e gëzuara e të sinqerta të fëmijëve për shfaqjen «Kështjella dhe helmi», shkruar nga Ismail Kadare. Regjisorin Pirro Mani, tashmë i mirënjohur për realizimet e tij skenike me nivel të lartë artistik nga veprat me përpjestime më të mëdha dramaturgjike si p.sh. «Cuca e maleve» «Fytëra e dytë», «Arturo Ui» apo opera «Komisari» etj., e shohim të verë në skenë dramën për fëmijë, të futet në botën e gjerë dhe interesante të fëmijëve

«Kështjella dhe helmi» është një pjesë me temë historike. Subjekti është i thjeshtë. Tre fëmijë. Urani, Teuta dhe Leka, në kohën që jepet urdhëri për t'u larguar nga kështjella për në strehim, fshihen, nuk largohen prej andej dhe vetëm pasi mbyllet portat e kështjellës dalin ku ishin fshehur. Kështjellarët, nga hambarët e gurtë të grurit pasi e marrin vesh prapësinë e fëmijëve, nxitojnë t'i nisnin për në strehim, por nuk është koha, sepse otomanët janë hedhur në sulm. Në qoftë se mund të thonim se deri këtu ishte një farë ekspozije e dramës, prej këtej fillon veprimi themelor dramaturgjik i veprës.

Të tre fëmijët, të shtyrë nga dëshira e madhe për të luftuar, të ushqyer me ndjenjën e dashu-

risë për Atdheun dhe urrejtjes për armikun, gëzohen që u jepet mundësia për të qëndruar brenda në kështjellë në kohën e sulmit. Ata do të kenë mjaft gjëra për t'u treguar shokëve të tyre, mbas betejës. Megjithatë të vegjëlit për të luftuar, ata janë gjithmonë në veprim; ngrohin ziftin, vrojtojnë, ndihmojnë luftëtarët me armë; bile i shohim edhe duke luftuar trup me trup me jeniçerët. Të gjitha ato gjëra të reja, që shikojnë apo dëgjojnë, bëjnë që tek ata të formohen tipare burrërore prej luftëtari, në fund do të shohim se është Leka ai që zbulon kryearkitektin otoman, i cili vjen për të helmuar pusin me ujë të pijshëm brenda në kështjellë. Drama mbaron me fjalët mjaft aktuale të komandantit të kështjellës: «Të mos gënjejemi nga shkëlqimi i jashtëm, sepse aty mund të jetë helmi më i fuqishëm».

Megjithatë tema që trajtohet në dramë i përket së kaluarës së largët të popullit tonë, tingulli aktual e përshkon atë nga fillimi deri në fund, nëpërmjet një optimizmi revolucionar. Kohët dhe mjetet ndryshojnë, por qëllimi i armiqve tanë, imperializmit dhe socialimperializmit, është po ai: të gjunjëzojnë popullin tonë trim. Forcimi i vigjilencës për të ruajtur vendin të paprekur dhe pastërtinë ideologjike nga çdo lloj helmi, i servirur nëpërmjet një shkëlqimi të jashtëm verbues, është theksuar në mënyrë shumë të dukshme nga të gjithë komponentët e shfaqjes.


Pjesa plotëson kërkesat e mosshës për të cilën është shkruar, i përshtatet psikologjisë së kësaj moshe, pionierëve, është e qartë dhe mjaft e kuptueshme, me një gjuhë shumë të natyrshme dhe me dinjitet artistik.

Ky spektakël u mëson njëkohësisht, jo vetëm fëmijëve, por edhe të rriturve, të mos harrojnë asgjë nga e kaluara, por ta kemi atë si një përvojë të çmuar revolucionare mbi bazën e së cilës po ndërtohet e ardhshmja.

Regjia, P. Mani, Q. Toro e A. Resuli, duke punuar me dashuri, ka hyrë me mjeshhtëri në botën, në psikologjinë e fëmijëve.

Shfaqja në të tërë elementët e saj është punuar me shumë frymëzim e fantazi. Spektakli ka unitet artistik, shumë të këndshëm dhe jetësor. Megjithatë vetë drama është e shkurtër, fantazia krijuese regjisoriale ka bërë që shfaqja të ketë kohën normale,

(vijen në f. 12)



Nga shfaqja e dramës «Kështjella dhe helmi».

**«U themi****ndal!»**

- Shfaqje e estradës

së Lushnjës -

**Filip Ndocaj**

**S**hfaqjen e estradës së Lushnjës me titull «U themi ndal!» e pamë para pak kohësh në Burrel, ku kjo trupë e dha gjatë turneut të saj. Nëpërmjet numrave të ndryshëm ajo ka për qëllim të fshikullojë botëkuptime ose qëndrime të huaja ndaj punës apo problemeve të tjera shoqërore që aty-këtu nceshen tek individë të shoqërisë sonë, në administratë apo në prochim, në familje apo në shoqëri. Ajo godet shfaqjet e burokratizmit, duke vënë në tehun e satirës disa tipa të burokratizuar, që ngurojnë të lenë zyrën e reharin e të shkojnë në prodhim; godet shfaqje të mosrespektimit të orarit të punës nga punonjësit të pakujdesshëm, të shpërdorimit të energjisë elektrike e fenomeneve të tjera negative si. p.sh. dasmat me shpenzime të tepërta etj.

E tërë shfaqja trajton probleme të aktualitetit që shqetësojnë të gjithë njerëzit tanë. Një anë e mirë është se në tërësinë e shfaqjes ndjehet koloriti i krahinës, si nga humori myzeqar, ashtu edhe nga këngët me motive popullore myzeqare, realizuar aq mirë nga orkestrina. Drejtuesi i saj, Rudak Ismaili, është njëkohësisht edhe autori i këngës më të bukur të kësaj shfaqjeje, «Fushës së Myzeqesë», kënduar me shije artistike nga Elida Koroshi. Kjo këngëtare e re, qoftë si soliste apo në duet me Aleksander Eufin, korri duartrokitjet e publikut, që mbushte sallën e shfaqjeve të


shtëpisë së kulturës së Burrelit, një publik sa i vëmendshëm, aq edhe artdashës, i etur, si kudo në vendin tonë, për shfaqje artistike.

Punë të mirë për realizimin e shfaqjes në përgjithësi ka bërë edhe regjisorin Vasil Noçka. Megjithatë mund të themi se disa skeçe nuk ishin realizuar mirë dhe jo gjithmonë për faj të tekstit. Humori në disa raste jepet me lodra fjalësh si: «Në rregull! Shumë në rregull!» (si shprehje ironike); tek skeçi «Vonesat në punë» veprimi skenik çakërdiset nga një burje-dalje jo e natyrshme e mërzi-tësë (motiv i stërpërdorur, po-chuaj nga të gjithë estradat tona) dhe që kulminon me skeçin «Racë amerikane», ku veprimi kthenet dendur në pantomimë groteske të pamotivuar e të paarrirë.

Edhe estradat e tjera duhet të përpiqen të mos bien në të meta të tilla, të cilat e bëjnë skeçin, dialogun e monologun të mërzi-tshëm.

Duke folur për aktorët nuk mund të mos përmendim punën e talentuar dhe të frymëzuar të aktore Athina Dhimitri që, në çdo pjesë ku ka rol, paraqitet në lartësinë e duhur artistike. Së bashku me aktorin Petraq Dhimitri, partnerin e saj, ata i japin shfaqjes humor të vërtetë. Të dy kanë një të folur të këndshëm e qëndrim skenik për t'u lavdëruar në çdo pikëpamje. Tek ky çift nuk shikojmë në asnjë rast, sig shprehim në disa aktorë të estradave tona profesioniste, maninë për të siguruar duartrokitjet e spektatorëve me anën e lëvizjeve groteske ose karikatuzimit të zërrit. I vetmi recitim i shfaqjes, një fragment i marrë nga poema e Drirero Agollit «Nënë Shqipëri» dhe interpretuar nga aktori Kostaq Papa, tingëllon disi mekanik, monoton, pa atë pathosin poetik që ka poema.

Shëmbulli i trupës së estradës së Lushnjës duhet të ndiqet edhe nga trupat e tjera të estradave tona. të cilat edhe më shumë e më një nivel më të mirë artistik duhet të japin shfaqje jo vetëm për publikun e rrethit të tyre, por edhe të rrethëve të tjera, duke pasur gjithmonë parasysh porosinë e Partisë e të shokut Enver për të çuar artin në skajet më të largëta të Atdheut.



Nga shfaqja e estradës së Lushnjës.